



**Republika e Kosovës**

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2019



**Komuna e Kaçanikut**

### **Procesverbal**

**Takimi i IV-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019**

**Më 22.08.2019**

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetarë i Komunës

**Zahir Doda**-Drejtor i DAK

**Halim Shehu**, Komandant i Policisë-Kaçanik

**Kjani Sallahu**, (mediet, OJQ-të, zejtarët, PAK-të)

**Fatmir Qaka**,EVSB

**Ramadush Osmani**-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencia

**Menduh Rexha**-Bashkësia Islame

**Shemsedin Abazi**-(KLSP)

**Vedat Dema**-Zyra për Barazi Gjinore

**Fadil Guri** , Zyra për Komunitete dhe Kthim

**Ali Vishi** , FSK

**Lirije Luta** , Komiteti për Komunitete

**Jashar Selimi** , Këshilli i Prindërve

Prezent me ftesë të KKSBB , të pranishëm ishin edhe Ferat Malsiu , përgjegjës i njësisë së Kompanisë „Pastërtia”në Kaçanik dhe Sami Stagova , përfajqsues i OMM „Gjethi”

Monitorues ishin zyrtarë nga OSBE-

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut z.Besim Ilazi dhe propozoi këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut
- 3.Diskutimi mbi dukuritë negative që rrezikojnë sigurinë e qytetarëve
- 4.Gjendja e ambientit dhe trajtimi i mbeturinave
- 5.Të ndryshme

### **1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar**

- Procesverbali u miratua nga të pranishmit

### **2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut**

Rreth kësaj pike Kryetari i dha fjalën Komandantit të Policisë të raportoj mbi gjendjen e sigurisë për periudhën në mes dy takimeve.

**Komandanti i Policisë:**Gjendja e sigurisë në komunën e Kacanikut në periudhën në mes dy takime ka qenë e qetë dhe stabile dhe ka përmisime të dukshme .Gjatë muajit Korrik sektori për hetime ka pranuar 30 raste . Rastet e zbuluara të muajit korrik 2019 dhe rasteve të periudhave të mëhershme tjera janë 33 . Krahasuar me muajin korrik të vitit paraprak niveli i zbulueshmërisë ka qenë 72 % ndërsa tani është 110 % , që don të thot se kemi 40 % më shumë raste të zbulueshmërisë . Gjatë muajit gusht deri më sot ku edhe po raportoj , sektori i hetimeve ka pranuar 23 raste , prej tyre 21 raste janë zbuluar dhe ndaj të dyshuarve është ngritë kallzim penal dhe lëndët janë dërguar në prokurori .

Veprat që kanë dominuar në muajin gusht janë: dhunë në familje 4 raste , lëndim i lehtë truporë 3 raste , kanosje 3 raste , dëmtim prone 2 raste , shantazh 1 rast , kanosje ndaj personit zyrtarë 1 rast , sulm 1 rast , shkaktim i rrezikut të përgjithshëm 1 rast , falsifikim i parasë 1 rast shërbim në pije alkoolike nën moshën 16 vjeqare 1 rast , aksident trafiku – godit e ik 1 rast dhe incident zjarri 1 rast .

Vlenë të ceket se në këtë muaj nuk kemi pasur asnjë rast vjedhje apo vjedhje e rëndë , çka don të thot se plani operativ „Prevntiva” që është në implementim e sipër , ka dhënë rezultatet e para dhe është treguar shumë efikas në parandalimin e krimit si dhe në identifikimin dhe kapjen e personave të dyshuar . Gjatë këtij muaji në tetë raste janë

identifikuar dhe kapur të dyshuar me lëndë narkotike (marihuanë) , ku kemi njoftuar njësitin anti-drogë nga regjioni të cilët më pastaj janë marrë me rastet .

Rezultate të mira ka pasur edhe në mbrojtjen e pyjeve , ku janë identifikuar një numër i madhë i dëmtuesve , ku disa janë kapur në flagrancë dhe u janë konfiskuar mjetet e punës , si motosharrat , traktorët dhe xhipat të cilat kanë qenë të përfshira në transportin ilegal të masës drusore si dhe është konfiskuar një sasi e madhe e masës drusore . Jemi në implementim e sipër të planit operativ – realizimi i urdhëresave gjyqësore 2019 dhe rezultatet janë evidente përkundër sfidave që paraqiten në teren . Patrollat e policisë janë shtuar dhe në bashkëpunim me inspektorët komunal po mundohemi të ruajmë rendin dhe qetësinë publike . Kamerat e sigurisë në qytet nuk janë të gjitha funksionale për shkak të punimeve që janë duke u bërë në rrugët e qytetit .

Një rast që duhet cekur është edhe largimi i mjetit të transportit publik „Qlirimi” nga komunikacioni për shkak se nuk ka qenë mirë teknikisht .

Me kërkesë të këshillit të fshatit Biçec dhe me pëlqim të familjes , kemi bërë realizimin e dërgimit të një personi të sëmurë mental në Qendrën Rehabilituese në Shtimje , i cili person shfaqte kanosje dhe agrisivitet në familje dhe në rrugë .

**Sami Stagova :** një gjendje jo e mirë është tek parkingjet ku persona të pandërgjegjshëm parkojnë automjete edhe nëpër trotuare . Më intereson të dijë se a mirren masa ndaj këtyre personave .

**Komandanti i Policisë :** Gjendja këtë vit ka qenë më e mirë falë shfrytzimit të oborrit të shkollës fillore „Emin Duraku” , por që kjo problematikë don zgjidhje të përhershme . Po hasim vështirsi edhe mbi pronësinë e hapsirave nëpër trotuare ngase pronarët e shtëpive thonë se është pronë private e ne nuk po mundemi të marrim masa . Kemi dhënë edhe xhoba aty ku e kemi parë të arsyeshme për me dhënë . Për krijimin e hapsirave tjera për parkingje ne kemi bërë kërkesë te Kryetari i Komunës dhe besoj që kët kërkesë komuna e ka shqyrtuar .

**Kjani Sallahu :** Falënderojmë Komendantin e Policisë për masat që kanë ndërmarrë pas kërkesës tonë në lidhje me personin me sëmundje mentale që shpeshherë me veprimet i tij ka qenë i dhunshëm edhe ndaj familjes së tij, e cila ka kërkuar strehimin institucional të personit në fjalë. Kisha një sugjerim për inspektorët e tregut që të jenë më aktiv gjet vizitave që ju bëjnë marketeve, sepse ka shum prej këtyre marketeve nuk kanë kushte elementare duke përfshirë edhe mungesën e klimatizimit e ku si pasojë e kësaj po ndodhin edhe helmime të ndryshme.

Në lidhje me transportin publik në fshatin Biçec shqetësimet kanë qenë të kahmotshme, por nuk ka pasur disponim institucional që ky problem të zgjidhet më herët. Ka indikacione

që nëse nuk zgjidhet çështja e transportit, të bojkotohet mësimi nga nxënësit e këtij fshati që udhëtojnë në Kaçanik . Sipas ankesave të banorëve, operatori i transportit publik nuk ka qenë në nivel të duhur as sa i përket orarit të udhëtimeve, as për gjendje teknike të mjetit të transportit, shpeshherë linja është mbajtur pa shofer të kategorisë adekuate, etj. Si kryetar i Fshatit Biçec kërkoj nga institucionet komunale dhe ato të sigurisë që nga 2 shtatori 2019, kur fillon mësimi, ose të ketë transport të rregullt e të sigurtë në relacionin Biçec-Kaçanik dhe anasjelltas ose nuk duhet të ketë fare transport të udhëtarëve. Udhëtarët duhet të janë të sigurtë!

**Ramadush Osmani :**Çdo fund vit ne bëjmë planin e linjave të reja dhe për aplikuesit kërkohet dokumentacioni i duhur , përndryshe ne nuk nuk u japim leje për operim .

**Lirije Luta :** kam informacion se në fshatin Vataj një i sëmurë mental keqtrajtohet nga familjarët e tij dhe pyetja ime është se a jeni të informuar në lidhje me këtë rast ?

**Komandanti i Policisë :** jemi në dijeni për këtë rast por problemi është se nga ky person nuk mundë të marrim asnje informacion përshkak të sëmundjes që ka .Këto raste duhet të zgjidhen duke bashkëpunuar me familjarë në rend të parë por edhe me të gjitha institucionet relevante që mirren me këtë kategori .

**Kryetari :** Përgëzoj komandantin e Policisë i cili me ardhjen e tij në këtë pozicion gjérat kanë filluar të ndryshojnë për të mirë sa i përket sigurisë në përgjithsi , andaj e inkurajojë të vazhdojë kështu dhe bashkëpunimi nuk do të mungojë me institucionet komunale .

### **3.Diskutimi i dukurive negative që rrezikojnë sigurinë e qytetarëve**

**Kryetari :** Zhurma nëpër kafiteri po vazhdon akoma edhe pse ndaj disa kafiterive u është vendosë edhe xhoba nga inspektorët komunal ngase kjo zhurmë ka vazhduar edhe pas orëve të mesnatës . Ne vazhdimisht kemi ankesa të qytetarëve rreth kësaj dukurie .

**Komandanti i Policisë :** Një dukuri e kahmotshme në komunën tonë ka qenë edhe lypsaria dhe ne përmes disa aksioneve kemi arritur të identifikojmë personat që mirren me këtë dukuri , janë intervistuar disa prej tyre dhe gjithashtu ndaj disa personave janë marrë masa duke i dënuar me xhobë . Sot është një situatë krejtë ndryshe sa i përket kësaj dukurie .

**Menduh Rexha :**Parkimi i automjeteve te hyrja e xhamisë po shkakton probleme ngase nuk po mundemi të kryejmë as shërbimet e tona . Kisha kërkuar nga policia që të ndërmerren masa që kjo hapësirë mos të shfrytëzohet për parking të automjeteve ose të vendoset ndonjë pengesë që do të pamundësonë këtë dukuri .

**Komandanti i Policisë :** Sa i përket parkimit ilegal të automjeteve ne i kryejmë detyrat duke marrë masa ndëshkuese e sa i përket vendosjes së pengesave në këtë hapësirë është kompetencë e Komunës .

**Kjani Sallahu** : Tash fillon edhe viti i ri shkollarë dhe më intereson të dijë se a ka planifikuar DAK diçka në lidhje me ndonjë aktivitet për parandalimin e dukurive negative nëpër shkolla?

**Zahir Doda** : Diçka të veqantë nuk ka , por që do të vazhdojmë me aktivitete që kemi ndërmarrë edhe në të kaluarën .

#### **4.Gjendja e ambientit dhe trajtimi i mbeturinave**

Rreth kësaj pike Kryetari i dha fjalën përgjegjësit të Kompanisë së Pastrimit Ferat Malsiut , që të tregoj mbi punën dhe sfidat që po kalon kjo kompani .

**Ferat Malsiu** : është e vërtetë se problemet më të mëdha të kompanisë janë në sezonin e verës ngase ka ngarkesë më të madhe për shkak të prezencës së mërgimtarëve . Presim që situata të ndryshojë për të mirë ngase po presim të furnizohemi edhe me tre kamion . Kjo gjendje mundë të them se është e njejtë në tër Kosovën por që po mendoj që në një të ardhme të afërt të ndryshojë për të mirë .

Për momentin nuk kemi makineri të mjaftueshme si dhe është shtuar numri i kërkesave . Problem po e kemi edhe me distancën e largët të deponisë , ku nevoiten tri orë për të kryer zbrazjen e mbeturinave . Problemin më të madh po e kemi me disa biznese të cilat nuk e kryejnë obligimin ndaj kompanisë në pagesë , por që krijojnë kaos me mbeturina . Problematikë tjetër është edhe mosvetdijsimi i qytetarëve në riciklimin e mbeturinave , që gjatë mbledhjes së tyre po na krijojnë probleme në makineri .

**Lirije Luta** : është e vërtetë se mungon një vetdijësim i qytetarëve në riciklim të mbeturinave , por që ka edhe atyre që nuk paguajnë shërbimin dhe mbeturinat i hedhin në ato vende që shohin kontanjerë .

**Komandanti i Policisë** : sa i përket kësaj dukurie ne jemi të gatshëm të asistojmë çdo herë që kompania apo inspektorët komunal e shohin të arsyeshme prezencën tonë .

**Kryetari** : me ato mundësi që kemi pasur ne si komunë kemi kontribuar dhe do ti ofrojmë çdo herë kapacitetet tona në përmisimin e gjendjes . Po presim që me blerjen e makinerisë së re për kompaninë kjo situatë do të ndryshojë për të mirë .Kërkesat tona për ndihmë nga donatorët kanë qenë të vazhdueshme dhe po shpresojmë që nga zyra japoneze dhe përmes IPA -fondeve të përfitojmë në këtë drejtim . Mendoj se duhet të interesohemi në eliminimin e defekteve të makinerisë .

## **5. Të ndryshme**

Në pikën e fundit të rendit të ditës , fjalën mori Sami Stagova , përfajqsues i OMM „Gjethi” i cili në emër të organizatës shprehu falënderimin për ftesën që ju është bërë për të qenë pjesë e këtij takimi dhe në emër të organizatës paraqiti disa kërkesa :

-Përpjekje më të mëdha nga Komuna/ Inspektori Komunal për ndalimin e hedhjes së mbeturinave nëpër deponi ilegale (mbeturina ndërtimore apo tjera) përmes identifikimit të degraduesve në mes të ditës dhe shqiptimit të më shumë gjobave si përgatitje me kohë pér ofrim të shërbimit në 100% të territorit komunal dhe menaxhim të tërësishëm të mbeturinave të cilin Komuna e Kaçanikut planifikon ta arrijë deri në fund të 2019. - Përveç furnizimit me 3 kamiona shtesë të mbeturinave i cili planifikohet deri në fund të viti 2019, duke marrë parasysh shërbimin e deritanishëm jo të kënaqshëm, propozoj që Njësia Komunale e Kompanisë Regionale të Mbeturinave të mbështetet edhe me kapacitete menaxheriale/ profesionale apo të kontraktohet ndonjë kompani private në mënyrë që shërbimi të jetë më kualitativ.

-Që pér deponimin e mbeturinave ndërtimore në deponinë e përcaktuar të mos aplikohet tarifa në vitet e para por e njëjtë të subvencionohet nga Komuna e Kaçanikut si pjesë e përmirësimit të mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit më të mirë të situatës në terren;

-Njësia komunale e Kompanisë të jetë në gjendje të marrë ndihmë më të shpeshtë pér mekanizëm

nga Qendra në Ferizaj pér rastet kur mekanizmi i saj është jo funksional.

-Të informohen amvisëritë/ bizneset nga Kompania/ Komuna se çfarë lloj mbeturine grumbullohet nga ata dhe kush i menaxhon llojet tjera të mbeturinave.

## **NDOTJA E UJËRAVE (LUMENJËVE)**

Si pjesëmarrëse në protestën e para disa ditëve, përveç faktit që lokacioni i Impjantit pér trajtimin e ujërave të zeza do të përcaktohet me Planin Zhvillimor Komunal i cili është në hartim e sipër, ne si organizatë ripërsërisim urgjencën e kërkeseve si në vijim:

-Pastrimin vjetor të shtratit të Nerodimes dhe ndoshta edhe të Lepencit në mënyrë që kundërmimi të jetë më i vogël;

-Fillimin e planifikimeve (buxhetit dhe tjera) të kolektorëve të kanalizimeve pér grumbullimin derdhjeve në jug të Komunës ku potencialisht gravitojnë kanalizimet e komunës;

-Presion më të madh në drejtim të Komunës së Ferizajt si ndotëse më e madhe .

-Ndërtimin e baseneve kulluese përmes të cilave mundë të aplikohej substancë biologjike pér trajtimin paraprak të ujërave të zeza dhe reduktimin e ndotjes.

## ÇËSHTJA E HIDROCENTRALEVE

-Marrjen e një Vendimi nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut për të ndaluar dhënjen e pëlqimeve/ lejeve të ndërtimit për hidrocentrale të reja si objekte shumë me rëndësi deri në hartimin dhe aprovinin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës të cilat janë në proces e sipër. Pas aprovimit të tyre do të vazhdohej me trajtimin e rasteve duke u bazuar në ato dokumenta bazë për Komunën. Me atë rast Gjethi do ta kishte shumë më të lehtë që "ti luftonte" degradimet mjedisore nga hidrocentralet në ndërtim dhe operim e sipër;

-Që Komuna gjithashtu të bëjë presion mbi MMPH-në për ndalimin e operimit ilegal të hidrocentralit Lepenci 3 në Sllatinë për shkak të mungesës së lejes së integruar mjedisore;

-Që Komuna të bëhej pjesë e kundërshtimit të degradimeve nga hidrocentralet në Lepenc.

-Komuna të shënjoj përmes shenjave dhe pengesave horizontale shtegun për këmbësorë në rrugën drejt shkollës fillore "Emin Duraku (Dushkajë)" nga hekurudha

-Policia të bëjë përpjekje më të mëdha përmes shqiptimit të gjobave dhe menyrave tjera që të mos bllokohet rruga/ trotuaret nëpër rrugën "Qamil Ilazi/ Sali Bajra" posaçërisht tani kur shkollat fillojnë mësimin.

**Kryetari :**lidhur me qështjen e ndërtimit të të hidrocentraleve është sensibilizuar mjaftë por që nuk është në kompetencën tonë lëshimi i lejendërtimit të këtyre hidrocentraleve andaj

kjo qështje duhej shtruar në nivelin qendrorë . Sa u përket ndotjes së lumenjëve ne gjithmonë kemi shfaqur shqetësimet tona në të gjithanivelet por kjo qështje ende mbetet vetëm shqetësim e reagime për të bërë diçka nuk ka . Ditë më parë është organizuar një protestë në oborrin e komunës por që mendoj që kjo protestë ka qenë e zbehtë si dhe organizatorët nuk e kanë përcaktuar vendin e duhur për të protestuar , sepse burimi kryesor i ndotjes vjen nga komuna e Ferizajit . Është bërë edhe një peticion në lidhje me këtë shqetësim dhe pjesë e nënshkrimit të këtij peticioni kam qenë edhe unë .

**Kjani Sallahu :** U jemi mirënlohës OMM „Gjethi” që me aktivitete të ndryshme vetëdijësuese po mundohen që gjendja e ambientit të përmisohet. Edhe unë jam i mendimit që protestat të janë më masive dhe të bëhen pran burimit të ndotjes- në Ferizaj. Nuk mund të protestohet në Kaçanik, përderisa ndotës është Ferizaj. Gjendja e mbeturinave nuk ka ndryshuar aspak për të mirë. Qe 10-12 vjet është e njejtë. Këtu para se gjithash kemi të bëjmë me menaxhim të dobët, s'ka tjetër arsy. Nuk është e ndershme që dështimi i menaxhimit të mbeturinave të justifikohet me fluksin e mërgimtarëve gjatë verës apo mos pagesën e tyre, as mungesa e kamionëve, e as deponia e mbeturinave në Velekincë. Kjo është ndërmarrje profitabile dhe nëse për 12 vjet nuk ka asnë investim apo zgjerim të kapaciteteve dhe të mbulueshmërisë së konsumatorëve, nuk ka se si të hidhet faji tjetërkund. Preblemi qëndron te menaxhimi i kompanisë. 70 % e qytetarëve i kryejnë obligimet. Ne në fshatin Biçec ka kohë që kërkojmë kontejnerë për mbulimin e ekonomive familjare 100 %, ndërsa përgjigjja është se nuk kemi kapacitete me mbulu më shumë. Si ka mundësi që ndërmarrja profitabile të ikë nga parja që i ofrohet. Madje edhe Komuna nuk ka nevojë të investojë në kompaninë “Pastërtia”, sepse ajo duhet të mbijetojë e të afarojë vetë. Pa një “refresh” të kësaj kompanie nuk ka përmirësim të menaxhimit të mbeturinave. Unë

propozoj që t'i jepet edhe një shans deri në fund të dhjetorit dhe nëse nuk përmirësohet gjendja, të merren masa për riorganizim të ri dhe substancial të njësisë në Kaçanik ose të insistohet që me mbeturinat të menaxhojë Komuna, e të mos përjashtohet mundësia e fundit që këto shërbime t'i besohen ndonjë kompanie private.

**Fadil Guri** : Më intereson të dijë se a ka ndërmarrë ndonjëherë kompania në fjalë fushatë vetëdëjësuese me qytetarë ? Fushatat duhen të bëhen nga kompania por edhe nga OJQ-të dhe të shfrytëzohen resurset njerëzore si nga kompania por edhe nga OJQ-të për të organizuar aktivitete vetëdijësuese .

**Ramadush Osmani** : shumë është punuar në përpilimin e planit për menaxhim të mbeturinave dhe po shpresojmë që me këtë plan ne do ta kemi edhe më lehtë të ofrojmë tek

donatorët kërkesat tonë .

Në fund të takimit u nxjerrën edhe rekomandimet të cilat ishin:

#### **REKOMANDIMET:**

- 1.Inspektorët e tregut dhe ata të ambientit të janë më aktiv në kryerjen e detyrave të tyre
- 2.Të zgjidhet çështja e transportit publik në fshatin Biçec
- 3.Angazhim dhe bashkëpunim më i madh i institucioneve relevante dhe familjeve në rastet e trajtimit të personave me sëmundje mentale
- 4.Të organizohen aktivitete vetëdijësuese për riciklim dhe trajtim të mbeturinave
- 5.Të shtrihen shërbimet e mbledhjes së mbeturinave në tër territorin e komunës
- 6.Të shtohen kapacitetet e ujit të pijshëm
- 7.Në Planin Zhvillimorë Komunal të parashihet edhe trajtimi i ujrave të zeza
- 8.Të bëhet presion edhe më i madhë ndaj Komunës së Ferizajit për të parandaluar ndotjen e lumenjëve Nerodime
- 9.Së paku një herë në vit të bëhet pastrimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrenjëve në territorin e Komunës tonë
- 10.Të mirret vendim nga Kuvendi Komunal për ndalimin e ndërtimit të hidrocentraleve në lumenjët dhe përrenjët në territorin e Komunës tonë
11. Të kërkohet që menaxhimi i kompanisë së mbeturinave t'i kaloj nivelit lokal

**Kaçanik 22.08.2019**

Kryesuesi:

Kryetari i Komunës

z.Besim Ilazi



Procesmbajtës:

**Fatmir Qaka**